



Njoftim i mediave

Data 26. Mars 2013

Procedura 48-orësh do të zgjerohet mbi Kosovë dhe Gjeorgji

Enti zviceran Federativ për Migracion (BFM) që nga 25. Marsi 2013 e zbaton procedurën 48-orësh edhe për kërkuesit e azilit nga Kosova dhe Gjeorgjia. Kthimet e shpejta prapa në atdhe mund të realizohen në të dy shtetet amë. Enti Federativ për Migracion për here të pare në Gusht të 2012 e futi në përdorim procedure e përsheptuar të azilit (Procedura 48-orësh) për personat nga shtetet evropiane të liruara nga obligimi i vizave. Që nga kjo kohë kërkesat e azilit nga këto shtete kanë shënuar një rënie të dukshme.

Që nga Gushti 2012 kërkesat e azili nga shtetet evropiane të liruara nga obligimi i vizave Serbia, ish Republika jugosllave Republika e Maqedonisë si dhe nga Bosnja e Hercegovina, vendosen me procedure 48-orësh, po që se nuk paraqite nevoja e sqarimeve të mëtutjeshme. Përvojat janë pozitive. Për këtë arsye procedurat e përsheptuara zbatohen më tutje me konsekuencë dhe zgjerohen edhe mbi dy shtetet e pa liruara nga obligimi i vizave Kosova dhe Gjeorgjia.

Në vitin e kaluar kërkesë për azil në Zvicër paraqiten 579 persona nga Kosova dhe 726 persona nga Gjeorgjia. Që të dy shtetet shfaqin një numër të lartë të kërkesave të pa arsyetueshme të azilit dhe në përputhje me këtë gëzojnë një mbrojtje të ulët të kuotave. Kuota e pranimit në vitin e kaluar për Kosovë ishte 0.6% dhe për Gjeorgjinë 0.3%. Vetëm gjashtë persona nga këto dy shtete vitin e kaluar e fituan azilin.

Nuk ka të nevojshëm për mbrojtje në kuptim të ligjit për azil

Këshilli Federativ në vitin 2009 Kosovën e ka klasifikuar si shtet të sigurt nga ndjekjet. Këtu bëhet fjalë për një shtet të ri, i cili gjendet në ndërtim e sipër, porse i cili bënë përpjekje të mëdha për integrimin e minoriteteve. Në lidhje me këtë Zvicra qëndron në kontakt të rregullt me autoritetet kosovare, të cilat mbështeten me projekte në kuadër të partneriteteve në lidhje me migracion (Ndërtim të banesave, qasje në arsimim).

Njoftim i mediave • Procedura 48-orësh e azilit: Zbatimi i mëtutjeshëm dhe zgjerimi mbi Gjeorgji dhe Kosovë

Kërkuesit e azilit nga Kosova, por edhe ata nga Gjeorgjia, sipas të gjitha rregullave nuk kanë nevojë për mbrojtje para ndjekjeve në kuptim të ligjit për azil. Njëkohësisht i zënë vendet e strukturave zvicerane të azilit, të cilat nevojiten për refugjatë të vërtet. Kjo gjendje çon deri te tejmbushja e strehimoreve dhe e dëmton besueshmërinë e sistemit zviceran për azil, i cili bazohet mbi parimet, që njerëzit vërtet të përndjekur këtu të gjejnë strehim dhe mbrojtje dhe të pranohen në mënyrë të denjë.

Procedura 48-orësh

Procedura 48-orësh zbatohet në qendrat e pranimit dhe procedurave (QPP=EVZ). Ekipet për intervista e mbyllin procedure brenda 48 orëve pas intervistës së parë mbi personin. Menjëherë pas lëshimit të vendimit negativ për azil inicohet kompletimi i dokumentacionit zëvendësues për udhëtim dhe sa herë që është e mundur dëbimi bëhet direkt nga QPP.

Në raste të kërkesave të refuzuara te ata persona, të cilët nuk e respektojnë afatin e lëshimit të vendit, rregullisht nxjerrët ndalesa e hyrjes në vend.. E njëjta gjë vlen edhe për personat të cilët e rrezikojnë sigurinë publike dhe kanë paraqitur pa arsytim kërkesa të shumëfishta.

Shtetet partnere informohen në biseda bilaterale mbi marrjen e këtyre masave. Kompletimi i dokumentacionit funksionon mirë dhe lëshimet e vendit kryhen shpejt. Kërkesat për azil të personave nga Kosova dhe Gjeorgjia, të të cilët paraqitet nevoja e sqarimeve të mëtutjeshme, sikurse deri me tani, trajtohen jashtë procedurës 48 orëshe.

Kontakti/Pyetje shitesë:

Michael Glauser, Enti Federativ për Migracion, T +41 31 325 93 50,
michael.glauser@bfm.admin.ch